

LIGJËRIMI PUBLIK PËR VRASJET NË KUFI (1988–1991)

Analizë e sensibilizimit dhe përfshirjes së aktorëve institucionalë dhe mediatikë në vitin 2025¹

I. HYRJE

Viti 2025 ishte vit zgjedhor, 50 vjetori i Aktit të Helsinkit dhe 35 vjetori i ngjarjeve të vitit 1990, gjatë të cilave u shënuan numër i lartë i vrasjeve në kufi. Duke qenë vit zgjedhor ishte e pritshme që të gjitha temat politike, përfshirë ajo e memories shtetërore dhe shoqërore, të ishin pjesë e agjendës politike. Nga monitorimi që ISP i ka bërë fushatës elektorale dhe ligjërimit politik dhe publik rezulton se tematika e vrasjeve në kufi, e personave të zhdukur apo e drejtësisë së munguar lidhur me këto vrasje nuk janë përfshirë në tematikën elektorale dhe asnjë subjekt politik nuk ka pasur ndonjë premtim elektorale lidhur me to në programet e tyre.

Vrasjet në kufi të vitit 1990, si dhe vrasjet e tjera të ndodhura në dy vitet e fundit të periudhës komuniste (1988-1991), janë fokus i angazhimit të ISP. Pjesë e këtij angazhimi është edhe monitorimi i sjelljes institucionale dhe ligjërimit politik e publik. Parimet e Helsinkit, ku bën pjesë edhe mbrojtja e jetës dhe parimi i lëvizjes së lirë, u injoruan tërësisht në regjimin e kaluar, ndërkohë që nuk iu kushtua rëndësi në trajtimin retrospektiv të tyre në këtë 50 vjetor as në mediat apo ligjërimit publik shqiptar.

Vrasjet në kufi nuk janë fenomen vetëm shqiptar, kanë ndodhur edhe në disa prej vendeve të tjera ish komuniste, përfshirë DDR (Gjermania Lindore), Rumania, Bullgaria, etj, por në rastin shqiptar kemi të bëjmë me numër të lartë vrasjes pas rënies së Murit të Berlinit dhe pas ndalimit të vrasjes përmes ndryshimeve që vetë regjimi i bëri Kushtetutës së RPSSH (maj 1990). Sipas këtyre ndryshimeve arratisja nuk do të ishte më vepër penale e klasifikuar si tradhti ndaj atdheut, pra që merr dënimin më të rëndë, dënimin me vdekje, por një shkelje administrative e kalimit të paligjshëm të kufirit, e cila dënohej maksimumi në 5 vjet. Nga miratimi i këtyre ndryshimeve deri në fundin e regjimit komunist (maj – dhjetor 1990) ndodhën më shumë se 50

¹ Ky raport monitorues është realizuar në kuadër të projektit “*Mbi viktimat e kufirit: Informim e sensibilizim për viktimat e vrasjeve dhe zhdukjeve gjatë arratisjeve në kufij gjatë viteve 1988-1991*”, i cili po mundësohet nga International Commission on Missing Persons, **ICMP**, përmes grantit të financiar nga **Bashkimi Evropian** në Shqipëri. Përbajtja është përgjegjësi vetëm e ISP-së.

vjeçare në kufi, disa prej të cilave nuk arritën asnjëherë të zbardhjen edhe për shkak se ndodhën në zonë kufitare midis Shqipërisë e vendeve të tjera, pa juridiksion të plotë hetimor nga njëri shtet.

Në këtë raport në fokus janë reagimet dhe përfshirja e institucioneve shtetërore, partive politike, mediave kombëtare dhe lokale në përkujtimin dhe trajtimin e çështjes së vrasjeve në kufi. Në listën e institucioneve bëjnë pjesë Kuvendi dhe qeveria, institucionet e drejtësisë dhe ato që merren me të drejtat e njeriut, bashkitë dhe këshillat bashkiakë, etj. Në listën e mediave kryesore bëjnë pjesë media televizive dhe ajo e shkruar, si dhe mediat sociale dhe lokale, të identifikueshme vetëm përmes rrjeteve sociale, kryesisht facebook dhe linkedin.

Një staf teknik i ISP u angazhua për të monitoruar të gjitha institucionet dhe median, duke krijuar database me të dhëna që lidhen me memorien dhe duke mbajtur shënim ato të dhëna që lidhen specifikisht me çështjen e personave të vrasje ose zhdukur gjatë viteve 1988-1991 në Shqipëri.

II. LIGJËRIMI PARLAMENTAR

Gjatë sesionit aktual parlamentar pati raste të pakta kur deputetët trajtuan çështje të memories dhe krimeve të periudhës komuniste. Nga monitorimi i ISP është regjistruar një rast i vetëm kur një deputet ka përdorur kohën e diskutimeve të lira për të adresuar çështjen e memories dhe personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste.

- Konkretisht, me 13 mars 2025 në prag të nisjes së fushatës elektorale deputeti i PSD Gertjan Deda² deklaroi në mbyllje të seancës “*një tjetër çështje shumë e rëndësishme është mungesa e një ligji për dënimin e krimeve të komunizmit. Akoma sot ne si shtet nuk kemi një ligj që t’i dënojë krimet e komunizmit dhe ata që kanë kryer krime ndaj njerëzve të pafajshëm. Ky është një dështim i madh për shoqërinë tonë, për dinjitetin e atyre që kanë vuajtur dhe historinë e kombit tonë. Krimet e komunizmit duhet të dënohen dhe ata që i kanë kryer, duhet të mbajnë përgjegjësi. Nuk mund të lejojmë që një pjesë e historisë sonë të mbetet e padënuar dhe pa ndëshkimin që meritojnë ata që kanë shkaktuar dhimbje dhe vuajtje pafund. Sot që po flasim, janë mbi 6 mijë familje shqiptare që nuk ua kanë gjetur eshtrat familjarëve të tyre të vrarë nga regjimi komunist dhe nuk kanë një varr për t’i kujtuar. Duhet të ndërtohet muri i kujtesës për nderimin e mbi 6 mijë shqiptarëve që i ka pushkatuar diktatura dhe ua ka zhdukur eshtrat. Kjo është një thirrje e fuqishme për të gjithë ne: është koha që të ndërmarrim veprime të menjëhershme dhe të vendosim një ligj për dënimin e krimeve të komunizmit, për të siguruar kompensimin e plotë të ish-të përndjekurit dhe për të rritur pensionet e ish-miniatorëve, duke u dhënë atyre dinjitetin dhe respektin që meritojnë. Kjo është një çështje e drejtësisë sociale dhe një detyrim moral që ka çdo shtetas ndaj atyre që kanë*

² Kuvendi i RSH. Datë 13.3.2025, fq. 36. Link:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202505300735567218Procesverbal%20%20dat%C3%A2B%2013.3.2025.pdf>

sakrifikuar për të ardhmen e vendit". Diskutimi i tij përfundoi me thirrjen për të mbështetur politikisht në fushatë partinë e tij politike, gjë që tregon edhe synimin e adresimit të këtij problemi në Kuvend, megjithatë kemi të bëjmë me një diskutim deputeti, me trajtimin e çështjes në Kuvend, me akt zyrtar të Kuvendit dhe me mbajtjen shënim në memorien e Kuvendit të kësaj problematike.

Një rast tjetër kur Kuvendi ka adresuar problematike të përafërta është diskutimi i datës 5 qershor 2025, pra pas zgjedhjeve parlamentare, dhe që ka objekt debatin publik mbi të ardhmen e burgut të Spaçit.

- Në këtë seancë deputetja Elda Hoti e kërkoi fjalën *“për një çështje sensitive që prek shtresën e ish-të përndjekurve politikë, për një krim ndaj kujtesës sonë historike, ndaj së vërtetës, ndaj viktimave të një regjimi që i burgosi, i torturoi dhe i vrau thjesht se mendonin ndryshe. Po flas këtu për restaurimin që po bëni ju në burgun e Spaçit, për masakrën e dytë që ju po bëni ndaj viktimave të komunizmit. Spaçi është dëshmi e gjallë e krimeve të diktaturës komuniste. Në emër të atyre që kanë vuajtur dhe të një Shqipërie që nuk mund ta ndërtojë të ardhmen duke fshehur të kaluarën, kërkoj transparencë të plotë mbi këtë projekt dhe ndërprerje të çdo ndërhyrjeje që rrezikon të tjetërsojë kujtesën historike në burgun e Spaçit”*³.
- Gjithashtu drejtuesja e Komisionit të Edukimit në Kuvend, deputetja Zhupa në vijim të seancës trajtoi çështjen e Spaçit, duke theksuar midis të tjerash se *“ju keni zgjedhur që ferrin ta zbukuron. Në fakt, aty duhet dëshmuar, është historia e Shqipërisë që shkruhet e që duhet t’u lihet fëmijëve tanë. Ata duhet ta kuptojnë se liria ka kosto. Ata duhet ta kuptojnë se ato mure nuk ishin të ngjyrosura me bojëra, por shikonin dhimbjen e pafund të njerëzve të persekutuar nga një regjim vetëm sepse mendonin ndryshe, flisnin ndryshe dhe nuk pranonin dhunimin, nuk pranonin atë model që ju sot e keni modelin tuaj të qeverisjes...ai kërkon dinjitet, kërkon të qëndrojë i zhveshur, i dhimbshëm, i ftohtë, i vërtetë, ashtu siç është, ku secili të ketë mundësi jo vetëm ta shikojë, por edhe ta studiojë, të jetë pjesë e kulturës shqiptare, të jetë pjesë e librave shqiptarë, të jetë pjesë e edukimit që duhet të marrë rinia shqiptare për atë çfarë ka përjetuar gjatë komunizmit dhe gjatë sundimit të diktatorit gjakatar Enver Hoxha... kjo është historia e Shqipërisë, kjo është historia e dhimbshme e Shqipërisë, ku secili është moralisht i detyruar të reflektojë, ku secili është moralisht i detyruar t’ua transmetojë brezave të ardhshëm..”*⁴.
- Në vijim edhe deputetja Andia Ulliri diskutoi për të njëjtën temë, duke theksuar *“mund të mbajmë mend. Si brez i ri, si brez që nuk e ka njohur atë diktaturë, mendoj se duhet ta rikthejmë vëmendjen në çështje të tilla, për të siguruar që historia të mbrohet, që të*

³ Kuvendi i RSH. Datë 5.6.2025, fq. 36. Link:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202506171155133492Procesverbal%20dat%C3%AB%205.6.2025.pdf>

⁴ Kuvendi i RSH. Datë 5.6.2025, fq. 43-44. Link:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202506171155133492Procesverbal%20dat%C3%AB%205.6.2025.pdf>

tilla ndërhyrje të mos bëhen me mungesë përgjegjësie të këtij niveli, por, në fakt, të ketë një bord të caktuar, i cili do të ndërmarrë hapa të kujdesshëm për të mbrojtur historinë, me qëllim që ajo histori dhe ato kujtime të mos vdesin, duke e lyer me bojë dhe vënë allçi në atë godinë”⁵.

- Deputeti tjetër Kastriot Piroli theksoi gjithashtu se “para se të shkohet te restaurimi i burgut të Spaçit, vizitat në të cilin duhet të futen urgjentisht në programet shkollore e mësimore, shteti duhet të punojë për të kuruar plagët e ish-të përndjekurve politikë, ku shumë prej tyre ende nuk kanë marrë pronat apo dëmshpërblimet për vitet e burgut⁶..”

Çështje të memories dhe krimeve të periudhës komuniste adresoi me 23 qershor edhe deputeti Bujar Leskaj⁷, Elda Hoti me 16 qershor, etj, por pa pasur direkt në fokus personat e zhdukur apo ata të vrarë në kufi gjatë periudhës së fokusit të këtij projekti të ISP-së.

Konkluzion?

Ligjërimi parlamentar tregon se nuk ka pasur trajtesë institucionale, por akte individuale deputetësh, të gjitha në kontekstin e nevojave politike të ditës dhe në kuadër edhe të gjuhës politike përballë palës tjetër politike. Asnjë nga deputetët e PS (mazhorancë) nuk pati artikulum lidhur me problematikën, përfshirë edhe anëtarët e nënkomisionit për të drejtat e njeriut. Ndërkohë që asnjëri nga kryetarët e partive kryesore politike gjithashtu nuk pati artikulum parlamentar lidhur me krimet e komunizmit, vrasjet, personat e zhdukur apo rastet e viteve 1988-1991. Megjithatë disa prej çështjeve që u trajtuan nga deputetët (më lart), kanë edhe sugjerime e rekomandime të vlefshme.

ISP vazhdimisht i ka kërkuar Kuvendit që në rastet kur deputetët, në diskutimet e tyre të lira në seancë, **adresojnë problematika e shqetësime**, ofrojnë zgjidhje ose rekomandime, struktura e Kuvendit duhet t’i ndjekë ato, të mbaj qëndrime nëse kërkohen ose të miratojë problematikat duke kërkuar ndjekjen e zgjidhjen e tyre. Kjo lidhet sa me funksionin mbikëqyrës të Kuvendit ndaj pushtetit ekzekutiv dhe raportit që Kuvendi ka me institucionet e pavarura, përfshirë ato të drejtësisë, aq edhe me thelbin e parlamentarizmit, standardet e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në përfaqësim dhe në funksionim.

⁵ Kuvendi i RSH. Datë 5.6.2025, fq. 51. Link:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202506171155133492Procesverbal%20dat%C3%AB%205.6.2025.pdf>

⁶ Kuvendi i RSH. Datë 5.6.2025, fq. 59. Link:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202506171155133492Procesverbal%20dat%C3%AB%205.6.2025.pdf>

⁷ Kuvendi i RSH. Datë 23.6.2025, fq. 23. Link:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202507040744260425Procesverbal%2C%20dat%C3%AB%2026.6.2025.pdf>

a. Ligjërimi elektoral

Gjatë fushatës elektorale 2025 ishte e pritshme që partitë dhe kandidatët kryesorë të kontaktonin kryesisht ish të përndjekurit politikë dhe të trajtonin edhe çështjet e memories për të kaluarën.

Nga monitorimi i ISP rezulton se janë zhvilluar së paku pesë konsultime të ndryshme me ish të përndjekur politikë, si dhe tematika e tyre është trajtuar kryesisht nga forcat e djathta politike dhe ato të reja.

- PS në qeveri, fituese e zgjedhjeve, nuk ka asnjë pikë në programin e saj elektoral lidhur me memorien ndaj të kaluarës, ish të përndjekurit ose të vrarët/zhdukurit, ndërkohë që partitë opozitës krahas deklarimeve – slogane për mbështetje, fokusohen kryesisht në çështje të dëmshpërblimit financiar.
- PD premtoi dekomunistizimin në tryezat konsultative, por nuk prezantoi ndonjë nismë konkrete, si dhe nuk e përfshiu këtë në prioritetet e programit elektoral.

Takimet individuale të kandidatëve për deputetë, disa prej të cilëve nuk arritën të fitonin mandatin, patën përfshirje më të thellë në problematikat e ish të përndjekurve, sidomos në zona të njohura për këtë trashëgimi, si në Shkodër, Tiranë, Mirditë, etj. Megjithatë në tërësi mund të vlerësohet se ligjërimi dhe angazhimi i tyre nuk merr vlerë për sa kohë ka pasur natyrë lokale, si dhe nuk është përkthyer në program politik dhe mandat parlamentar.

Konkluzion?

Mungesa e debateve politike dhe elektorale midis kandidatëve për kryeministër, kandidatëve kryesorë dhe vetë partive politike pamundësoi një diskutim lidhur me problematikat prioritare, ku bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me memorien dhe krimet e pazbardhura të periudhës komuniste.

Individë të veçantë, studiues apo analistë, vëzhgues të jetës publike e sociale, mbajtën qëndrime në misione televizive, në rrjetet sociale, gazeta print apo tribuna të tjera, duke ndihmuar në mënyrë modeste në informimin dhe sensibilizimin publik.

Vetë **shoqata të ndryshme të ish të përndjekurve** politikë adresuan në publik problematikat e tyre, përfshirë rastet e personave të zhdukur, organizatat e shoqërisë civile që ishin në projekte ose në fokusim mbi të drejtat e njeriut gjithashtu patën reagime, qëndrime dhe aktivitete, por në tërësi asnjëra prej dy kategorive, pavarësisht sensibilitetit, nuk arritën të impononin kalimin e kësaj tematike në agjendën prioritare të debatit publik dhe elektoral.

III. QASJA INSTITUCIONALE

Reagimet institucionale kanë të bëjnë me nisma politike, nisma parlamentare, vendimmarrje në ministri ose në Këshillin e Ministrave, etj, pra akte zyrtare të reagimit dhe trajtimit të problematikës.

Nga monitorimi i ISP rezulton se gjatë vitit 2025 nuk ka pasur akte ligjore, nënligjore dhe as praktika të reja administrative e politike lidhur me tematikën e vrasjeve në kufi, personave të zhdukur dhe krimeve të periudhës komuniste në përgjithësi. Mungesa e akteve të tilla lidhet sa me mungesën e një qasje strategjike të institucioneve, mungesë të vullnetit politik dhe tendencën për ta relativizuar të kaluarën e pasojat e saj.

Agjenda kryesore e institucioneve përcaktohet kryesisht nga mazhoranca në parlament, e cila është edhe mazhorancë në qeverisjen vendore, si dhe dominuese në vendimmarrjet lidhur e institucionet qendrore dhe pushtetin ekzekutiv. Fokusi i saj kryesor, kryesisht në funksion të interesit elektorale, kanë qenë veteranët dhe grupimet e tyre, të cilat janë edhe pjesa më kontestuese ndaj krimeve të komunizmit. Kur mazhoranca nuk e përfshin tematikën në çështje prioritare, as aktorët e tjerë politikë nuk krijojnë pritshmëri. Ato nuk kanë fuqi ndikuese dhe as interes strategjik politik për të nxitur një debat që nuk reflektohet në rezultatet e dëshiruara elektorale.

Kuvendi, përmes Komisionit të Ligjeve, nënkomisioni për të drejtat e njeriut, ka dëshmuar gatishmëri në janar 2025 të zhvillojë tryezë dëgjimore me ISP dhe partnerë të tjerë të shoqërisë civile lidhur me vrasjet në kufi dhe personat e zhdukur. Seanca dëgjimore u pamundësua për shkak të ndryshimit të agjendës politike dhe mbivendosjes nga aktivitetet me natyrë elektorale, megjithatë bazuar në monitorimin e ligjërimit parlamentar dhe qasjes institucionale mund të theksohet se me përjashtime të pakta deputetësh, Kuvendi posedon informacione minimale lidhur me këtë problematikë.

3.1. Kuvendi, deklarata e kryetares së Komisioni të Edukimit

Në aspektin institucional vlen të theksohet në mënyrë specifike përgjigjia pozitive që znj. Ina K. Zhupa, kryetare e Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, bëri me 24 korrik 2025 pas kërkesës së ISP⁸. Deklarimi i saj zyrtar përbën rastin e parë të një funksionari të lartë shtetëror, sidomos të një kryetari të komisionit parlamentar, lidhur me çështjen e të vrarëve në kufi 1988-1991. Në deklaratën e kryetares së Komisionit të Edukimit theksohej:

⁸ Deklarata e kryetares së komisionit të edukimit në Kuvend, 24.07.2025, link <https://www.facebook.com/inazhupaPD/posts/pfbid023Z3ARRhoYrY3HmNMhCPenQmRXLTUYA65oKkaaAGqvd4FNZvec6U2NacMLovKooXrl?>

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezoluta që dënojnë krimet e komunizmit dhe që promovojnë vlerat euroatlantike, përfshirë edukimin demokratik, memorien kolektive dhe të drejtat e njeriut. Shqipëria vjen nga një trashëgimi staliniste, ku koncepti i lirisë dhe të drejtave të njeriut mohohej dhe dënohej dhe ku jeta e njeriut nuk kishte mbrojtje faktike ligjore dhe as kushtetuese.

Duke mbështetur punën e Bashkimit Europian, ICMP dhe faktorëve të tjerë që janë angazhuar në çështjet e memories, si dhe duke vlerësuar adresimin që Instituti i Studimeve Politike (ISP) i ka bërë Kuvendit të RSH vlerësoj se një nga çështjet për të cilat duhet të kemi rezultate konkrete, sensibilitet dhe reagim gjithë institucional është ajo lidhur me vrasjet në kufi në periudhën e fundit të regjimit komunist.

Përgjatë viteve 1989-1990 disa dhjetëra të rinj dhe qytetarë humbën jetën duke u ekzekutuar nga forcat e kufirit në përpjekje për largim nga Shqipëria, secili prej tyre i paarmatosur dhe i pa përfshirë në vepra penale ose konflikt që mund të vinin në rrezik sigurinë kombëtare. Ata ishin qytetarë që kërkonin lirinë, ëndërronin një jetë më të mirë dhe u motivuan nga vala e emigrimit nga vendet ish komuniste. Shqipëria ishte vendi me numrin më të lartë të të vrarëve në kufi, sidomos në vitin 1990, pra pas rënies së Murit të Berlinit.

Në gjysmën e dytë të vitit 1990 disa nga aktet e arratisjes jashtë vendit u shoqëruan me ekzekutimin e qytetarëve, akt i ndaluar edhe me Kushtetutën dhe ligjet e kohës në fuqi. Vrasjet në kufi u shoqëruan me zhdukje të trupit të viktimave, refuzim të varrimit familjar apo keqtrajtim publik të kufomave. Lista e hartuar dhe e adresuar në Kuvend nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) është një tablo e plotë e këtij krimi shtetëror në ditët e fundit të regjimit.

Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj problematike dhe nevojën për një rol aktiv të Kuvendit dhe të institucioneve në trajtimin e zgjidhjen e tyre, sipas praktikave më të mira të vendeve të BE-së, me cilësinë e deputetes dhe të kryetares së komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik deklaroj se:

- Shteti e shoqëria nuk kanë arritur ende të krijojnë ndarje morale dhe të drejtë me të kaluarën, sidomos me viktimat me motive politike. Vrasjet në kufi, vrasjet politike brenda vendit, si dhe lista e gjatë e personave pa varr mbetën trashëgimi negative.*

- Shteti shqiptar ka detyrimin për hetimin e plotë të rasteve, marrjen e përgjegjësisë, rregullimet ligjore dhe administrative, si dhe gjetjen dhe rehabilitimin e viktimave, si parakusht për integritetin e parimeve kushtetuese, vendosjen e drejtësisë, nxitjen e dialogut mbi të kaluarën dhe të edukimit shoqëror.*

- Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave kanë rol thelbësor në plotësimin e bazës ligjore dhe financiare, të angazhimit dhe sensibilizimit, për të siguruar të dhëna të plota, transparencë dhe database zyrtare dhe publike.*

• *Këshilli i Ministrave duhet të miratojë VKM sipas ligjit, për të mundësuar fillimin e zbatimit real dhe integral të ligjit mbi personat e zhdukur/vrarë, të bëjë ndarjen e qartë të kompetencave për institucionet e përfshira dhe të koordinojë aktivitetin e tyre.*

• *Legjislacioni u njeh bashkive dhe institucioneve lokale përgjegjësinë për të ruajtur dhe zhvilluar vlerat kulturore dhe historike vendore, organizimin e veprimtarive, nderimin e individëve /ngjarjeve dhe si akte të tjera që lidhen me memorien, traditën, identitetin dhe dialogun qytetar. Shumica e bashkive në zonat kufitare, në të cilat janë shënuar ngjarje të rënda të vrasjeve në kufi në vitet 1988-1991 nuk kanë një sistem identifikimi dhe vlerësimi, aktivitete që lidhen me memorien dhe as fokus institucional për hetimin e rasteve të personave të zhdukur.*

• *Institucionet vendore që lidhen me kulturën, kujtesën, trashëgiminë, turizmin dhe sistemin arsimor, bazuar në praktikën e mira, duhet të përfshihen, programojnë dhe të veprojnë për të identifikuar, nderuar dhe përkujtuar viktimat politike të vrasjeve në kufi.*

• *Sipas ligjit 69/2012 në sistemin arsimor respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe liritë e njeriut, sigurohet e drejta për arsimim cilësor, garantohet veprimtaria formuese, si dhe i gjithë procesi bazohet në parimin e përfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies. Bazuar në praktikën e vendeve në BE, MAS dhe institucionet përgjegjëse duhet të përfshijnë dhe trajtojnë dëshmi dhe veprimtari cilësore që informojnë dhe formojnë të rinjtë mbi periudhën komuniste, si dhe krimet mbi vrasjet në kufi.*

• *RTSH dhe institucionet e tjera informative publike kanë përgjegjësi, rol dhe mundësi të përfshijnë në programet e tyre këtë problematikë, në funksion të informimit të saktë, ndërgjegjësimi dhe kulturës së memories dhe drejtësisë transitorë, sipas praktikave më të mira të medias publike në vendet ish komuniste anëtare në BE.*

Konkluzion?

Deklarata u publikua më pas nga shumica e mediave online, përfshirë edhe portale kryesore si Balkanweb, Panorama, Politiko, Newsbomb, etj, dhe median e shkruar të ditës pasuese. Deklarata u ndaj edhe në median sociale të ISP-së dhe rrjetin e bashkëpunëtorëve të shoqërisë civile.

Thelbi i rëndësisë së deklaratës ka të bëjë me jetësimin e një akti që përfshin Kuvendin, përfshirë legjislaturën e ardhshme, si dhe me përmbajtjen e deklaratës, e cila njeh, konfirmon dhe adreson elementët kryesorë që lidhen me memorien, vrasjet në kufi, përgjegjësitë shtetërore e shoqërore, përgjegjësitë politike e institucionale, si dhe rekomandimet për ndërhyrje. Deklarata konfirmon edhe disa prej shqetësimeve dhe rekomandimeve të ofruara nga ISP në aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit.

IV. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TJERA

Gjatë periudhës së monitorimit nuk ka pasur ndonjë rast kur organet e drejtësisë, prokuroria apo zyrtarë të Policisë të kenë mbështetur ose iniciuar ndonjë akt zhvarrimi e hetimi lidhur me personat e zhdukur dhe pa varr, apo për vrasjet në kufi në periudhën 1988-1991. Kjo tematikë nuk u përfshi as në agjendën dhe produktet e komisioneve të posaçme për reformat në parlament dhe as në planin e veprimit për reformat, si dhe në strategjitë e ndryshme ministrore dhe sektoriale lidhur me sfidat e shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Ka pasur raste kur ndonjë institucion, si Autoriteti i Dosjeve (AIDSSH) apo Instituti për Studimin e Krimeve të Komunizmit (ISKK) kanë trajtuar ngjarje e raste të veçanta që lidhen me vrasjen në kufi dhe personat e zhdukur, por kryesisht kjo është bërë në rastet e ndonjë date përvjetori ose ndonjë zhvillimi politik ditor.

Nga ana tjetër monitorimi dëshmoi edhe se Avokati i Popullit dhe komisionerët që mbulojnë çështje të diskriminimit dhe të drejtave të njeriut, nuk kanë shprehur asnjë qëndrim publik apo nuk kanë iniciuar ndonjë akt lidhur me hetimin, zbardhjen apo trajtimin institucional të rasteve së të vrarëve në kufi dhe as personave të zhdukur.

Në aspektin praktik të qasjes ekzekutive dhe nga institucionet e tjera, nga monitorimi rezulton gjithashtu se, p.sh.:

- Ministria e Kulturës, Ekonomisë dhe Inovacionit (ministria përgjegjëse) nuk ka përfshirë asnjë aktivitet apo tematikë që lidhet me përkujtimin e vrasjeve në kufi për periudhën 1988–1991 në kalendarin kulturor vjetor.
- Bashkitë vendore nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë për nisma sensibilizuese në nder të viktimave.
- Ministria e Arsimit nuk ka kryer reformën e teksteve në funksion të përfshirjes në programet e reja të çështjeve të memories dhe krimeve të periudhës komuniste
- Institucionet e tjera ekzekutive, si dhe ato të qeverisjes vendore, nuk kanë gjithashtu nisma konkrete dhe akte vendimmarrëse lidhur me këtë problematikë.

Gjithashtu vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe, përveç nismave që kanë ardhur nga organizata të shoqërisë civile që kanë në fokus këto problematika, si dhe presionit pozitiv të tyre për të ndikuar në debatin publik e politik, nuk janë shënuar raste të projekteve kërkimore institucionale lidhur me periudhën komuniste, sidomos nga institucionet kërkimore (universitete, institute dhe qendra kërkimore) të financuara nga buxheti shtetëror. Për shembull, lidhur me korrikun 1990, ku pati edhe një të vrarë të konfirmuar, vetëm ISKK dhe më pas ambasada gjermane në Tiranë organizuan aktivitete, - asnjë i tillë nuk u bë nga bashkia kryesore (Tiranë), ministria përgjegjëse ose institucionet e tjera me fokus memorien dhe të drejtat e njeriut.

Kryesisht donatorë mbështetës të shoqërisë civile dhe zërave të tjerë civile e institucionalë janë programe të ndryshme ndërkombëtare dhe shtete perëndimore, një tregues kritik për kapacitetet dhe fokusimin strategjik të shtetit dhe institucioneve tona.

V. Përfshirja e mediave lokale dhe aktorëve të pavarur

- Mediat lokale kanë treguar një angazhim më të dukshëm në krahasim me ato kombëtare, duke përgatitur kronika përkujtimore dhe publikime të dëshmive të familjarëve të viktimave. Gjithashtu, mediat lokale kanë mbuluar edhe ceremoni përkujtimore të organizuara nga komuniteti lokal (shiko link 7)
- Rrjetet sociale janë një platformë e rëndësishme për dokumentimin e vrasjeve në kufi. Faqe si *Neutrale*, *Shoqnia Bashkimi*, apo *Shkodra Blog* publikojnë rregullisht dëshmi dhe dokumente që lidhen me këto ngjarje, duke mbajtur gjallë interesin publik. Vlen të theksohet se në komente mund të dallohen dhe përpjekje për zbardhje të mëtejshme të këtyre ngjarjeve.
- Platforma arkivore të pavarura si *kujto.al* dhe studiues individualë si Kastriot Dervishi luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e dokumentacionit dhe publikimin e materialeve historike për këto vrasje.

Nga monitorimi i mediave sociale rezulton se krahas elementëve pozitive (rasteve të mësipërme ose publikimeve nga ISP dhe organizatat e tjera partnere të përfshira në projekte me ICMP-në) ka edhe reagime të qytetarëve të ndara në tri kategori.

1. Kategoria e parë, qytetarët që tregojnë sensibilitet dhe ndjeshmëri dhe që kanë qasje kritike ndaj mënyrës sesi shteti e shoqëria shqiptare ende nuk kanë arritur të zbatojnë një politikë e strategji trajtimi me dinjitet e respekt të memories mbi të kaluarën dhe viktimat politike të saj. Kjo kategori qytetarësh është aktive në komente, në ofrimin e të dhënave shtesë për viktimat e vrasjeve në kufi ose ngjarjeve të lidhura me to. Për shembull, në rastin e vrasjes së Përparim Pashakos, një komentues X e zbardh rastin edhe më tej duke rrëfyer se mbas vitit 1992, ish kryetari i degës V.H u dënua kurse komandanti i kufirit P . XH u arratis në Greqi.
2. Kategoria e dytë përfshin individë që kanë nostalgji mbi të kaluarën, janë kritikë për çdo aktor civil dhe institucional që kritikon periudhën komuniste dhe kërkon drejtësi e respekt për viktimat politike të saj. Duke qenë vit elektorale kjo kategori ndikohet edhe nga debatet elektorale të ditës dhe ndjek thujtë në mënyrë identike linjat partiake dhe raportet e tyre me memorien historike, periudhën komuniste dhe trashëgiminë e saj. Kjo kategori dallohet po ashtu një tendencë për të amnistuar aktet e dhunës të kryera nga autoritetet kufitare të regjimit komunist, si p.sh., në rastin e një postimi lidhur me vrasjen e A. Grudës në kufi (1990) ku një komentues thotë se viktimat u sakrifikuan nga prindër që donin të linin vendin apo justifikojnë në emër të sovranitetit politikën e Hoxhës. Këto reagime të opinionit publik ndikojnë negativisht në procesin e zbardhjes të së kaluarës dhe dëmton përpjekjet për drejtësi tranzitore në Shqipëri.
3. Kategoria e tretë ka të bëjë me individët që tentojnë të ofrojnë më shumë informacion cilësor, që kërkojnë më shumë studime dhe analiza, që kanë qasje profesionale mbi tematikën dhe që kanë informacion dhe duan ta përdorin në mënyrë pozitive dhe aktive

atë në funksion të drejtësisë tranzicionale. Ata ofrojnë edhe sugjerime e rekomandime nga praktika e vendeve të tjera europiane Këta janë të pakët por përbëjnë edhe zërat më të arsyeshëm në mediat sociale.

VI. PËRFUNDIME

Vrasjet në kufi gjatë viteve 1988–1991 përbëjnë një formë dhune shtetërore dhe një rast tipik ku përfshihet e gjithë struktura shtetërore. Në dallim nga tranzicioni, nuk kemi të bëjmë me humbje jete që vijnë nga emigracioni i parregullt klandestin, por nga ekzekutimi zyrtar, vendimmarrja zyrtare dhe vlerësimi zyrtar. Duke qenë të tilla vrasjet në kufi përbëjnë prova konkrete, evidenca dhe raste që meritojnë hetime shteruese, zbardhje të së vërtetës, gjetje të viktimave të varrosura pa dijeninë e familjes dhe trajtimi i tyre rehabilitues në demokraci, si një krim me burim shtetin dhe një shtet i së drejtës që reflekton, kërkon ndjesë dhe inicion drejtësi tranzicionale.

- I. Shqipëria ka dështuar të ndërtojë dhe zbatojë një narrativë shtetërore dhe institucionale të memories për qytetarët e vrarë në kufij, si dhe gjatë vitit 2025 Shqipëria nuk bëri përpjekje serioze ta trajtojë këtë problematikë në strategjitë sektoriale, agjendën ekzekutive, në fushatë elektorale dhe as në nismat reformuese në kuadër të shtetit të së drejtës dhe anëtarësimit në BE.
- II. Monitorimi nga ISP tregoi se çështja e vrasjes së kufi nuk është ende prioritet institucional dhe politik dhe se institucionet nuk e konsiderojnë ende atë pjesë të planit afatshkurtër të veprimit dhe as të përgjegjësisë direkte morale e juridike. Kjo ndodh kryesisht edhe për shkak të pafuqisë së tematikës për imponim. Në leximin elektoral do të thotë se trajtimi i kësaj çështjeje nuk sjell vota, pra nuk përbën një temë me përfshirje masive të votuesve të mundshëm, dhe pa këtë potencial votash nuk përbën një tematikë me interes strategjik elektoral apo qeverisës.
- III. Monitorimi tregoi se media gjithashtu nuk e ka prioritet çështjen e memories ndaj të kaluarës dhe as trajtimin e të vrarëve në kufi, dhe se ajo kryesisht mbajtohet me riprodhimin e lajmeve përkatëse që vijnë nga politika dhe retorikën e saj. Mungesa e ekspertizës në media shoqërohet me mungesën e njohurive praktike për tematikën nga ana e gazetarëve dhe reporterëve të cilët transmetojnë përpara lexuesit/dëgjuesit vetëm atë që ofrojnë politikët dhe institucionet politike. Kështu, kur ka pasur reagime nga institucione, media e përcjell të njëjtën deklaratë, të njëjtin tekst dhe të njëjtin qëndrim, pa e shoqëruar atë me komente, interpretime ose të dhëna plotësuese shtesë nga vetë media/gazetarët.
- IV. Kuvendi, deputetët dhe media, si dhe vetë strukturat që mbulojnë programet dhe të drejtat e njeriut në partitë politike parlamentare, do të duhet të marrin më shumë informacion cilësor, të trajnohen dhe të informohen rregullisht mbi këtë tematikë dhe praktikën e mira të trajtimit të saj në vende ish-komuniste anëtare në BE. Deklarata publike e kryetares së Kom. Edukimit me 27.07.2025 në Kuvend përbën rastin e parë dhe këtë vit, të vetmin, kur një zyrtar i lartë ngre dhe adreson tematikën e personave të vrarë në kufi, dhe mungesën e qasjes institucionale rreth memories historike, por edhe tregon gjithashtu se vetëm individët me pushtet kanë potencial për të krijuar opinion publik dhe për të përfshirë institucione të rëndësishme si Kuvendi i RSH në trajtimin e tyre.

- V. Institucionet që trajtojnë të drejtat e njeriut dhe memorien historike, që kanë në fokus kërkimin dhe hulumtimin profesional, arkivat dhe të dhënat dokumentare, rastet e munguara të së dhënies së drejtës dhe deformimet e kësaj të drejte në periudhën e fundit të sistemit komunist, si dhe që shfaqen si zëdhënëse të qytetarëve dhe interesit publik duhet të bëjnë shumë më tepër për të justifikuar misionin e tyre dhe për të ndihmuar në jetësimin e drejtësisë tranzicionale, dekomunistizimit dhe forcimin e shtetit të së drejtës përmes reflektimit, dialogut të hapur drejtësisë funksionale dhe besimit të vlerat demokratike.
- VI. Mungesa e vëmendjes institucionale, mediatike dhe politike në përvjetorin e 35-të të këtyre ngjarjeve është tregues i neglizhencës kolektive që rrezikon përpjekjet për drejtësi dhe ballafaqim me të kaluarën.

Ekipi monitorues i ISP ka bindjen se vetëm përmes angazhimit të shtuar të institucioneve shtetërore, mediave dhe faktorit politik, rolit aktiv civil dhe potencialit reagues, mund të shpresohet që krimet e së kaluarës të mos mbeten të pandëshkuara, që shoqëria të reflektojë dhe të nxjerr mësim nga e kaluara, për të krijuar një vizion dhe vullnet më të qartë lidhur me drejtësinë transitore, të drejtat e njeriut dhe vlerat e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Burimet:

- 1) 16 Qershor 2025 (Shkodraweb) - DOSSIER – Urdhri që vrau 17-vjeçarin Pëllumbi në kufi, arratisjet e paparashikuara dhe plumbat që shkurtonin jetën e djemve të rinj. Link: <https://www.shkodraëeb.com/dossier-urdhri-qe-vrau-17-vjecarin-pellumbi-ne-kufi-arratisjet-e-paparashikuara-dhe-plumbat-qe-shkurtonin-jeten-e-djemve-te-rinj/>
- 2) 20 Qershor 2025 (Newsin) - 35 vjet nga vrasja e dy 24-vjeçarëve në kufi. Link: <https://neësin.al/35-vjet-nga-vrasja-e-dy-24-vjecareve-ne-kufi/>
- 3) 1 Prill 2025: (Neutrale) - Vrasja e Përparim Pashakos më 1 Prill 1990. Link: <https://www.facebook.com/neutrale.al/posts/vrasja-në-kufi-e-përparim-pashakos-më-1-prill-1990më-datën-141990-ditën-e-diel-n/637817809010597/>
- 4) 9 Qershor 2025 (Neutrale) - Qershori I përgjakur. Link: <https://www.facebook.com/share/1AzCnBptTb/?mibextid=ëëXIfr>
- 5) 7 Korrik 2025 (Radi & Radi) - 33 jetë të ndaluara në kufi - Mbas 35 vitesh asnjë përgjegjës - Turp kombëtar. Link: <https://www.radiandradi.com/33-jete-te-ndaluara-ne-kufi-mbas-35-vitesh-asnje-pergjegjes-nje-turp-kombetar/>
- 6) 16 Qershor 2025 (Tv1 Channel Shkodër) - 35 vite nga vrasja e Pëllumb Pëllumbi në kufirin e Shkodrës, qyteti kujton me solemnitet martirin e demokracisë. Link: https://www.instagram.com/reel/DK9qUB4PP_H/?igsh=MËx1ZXVqZ24zNDc4Më=
- 7) 9 Qershor 2025 (Shkodra Blog) - Qershori i përgjakur. Link: <https://www.facebook.com/share/1G1QmB1DUN/?mibextid=ëëXIfr>
- 8) 16 Korrik 2025 (Shoqnia Bashkimi - 1899) - Link: <https://www.facebook.com/shqip2016/posts/pfbid02gDa7jib2r55Kx79TtVopZPrQ1NxAi2MZjgN576NkuRfPmF1SdeUPoyd5t9rZ9ëBZl>
- 9) 19 Korrik 2025 (Kastriot Dervishi) - 35 vjet nga vrasja ne kufi e te rinjve nga fshati Barc i Korces. Link: <https://www.facebook.com/share/p/17dMmky216/?mibextid=ëëXIfr>
- 10) 18 Korrik 2025 (Kastriot Dervishi) - 35 vjet nga vrasja ne kufi e Muharrem Velajt. Link: <https://www.facebook.com/share/p/18tËZNt5Hx/?mibextid=ëëXIfr>
- 11) 28 Maj 2025 (Shkodra Blog): Maj 1990, muaji i vrasjeve ne kufi. Link: <https://www.facebook.com/share/p/18tËZNt5Hx/?mibextid=ëëXIfr>
- 12) 24 Korrik 2025 (Politiko.al): Murders at the border during the communist regime/ Zhupa: Need for sensitivity and institutional response! Link: <https://politiko.al/english/ditari-i-opozites/t-ne-kufi-gjate-regjimit-komunist-zhupa-nevoje-per-sensi-i536753>
- 13) 24 Korrik 2025 (Balkanweb.com): Link: <https://www.balkanëeb.com/ina-zhupa-nevoje-per-sensibilitet-dhe-reagim-institucional-per-krimet-shteterore-te-vrasjeve-ne-kufi-gjate-regjimit-komunist/#gsc.tab=0>
- 14) 24 Korrik 2025 (Hashtag.al): Link: <https://www.hashtag.al/index.php/2025/07/24/zhupa-konkon-reagim-institucional-per-vrasjet-ne-kufi-gjate-komunizmit/>
- 15) 24 Korrik 2025 (faxëeb.al) : Link: <https://faxëeb.al/ina-zhupa-nevoje-per-sensibilitet-dhe-reagim-institucional-per-krimet-shteterore-te-vrasjeve-ne-kufi-gjate-regjimit-komunist/>
- 16) 24 Korrik 2025 (kohajone.com): Nevojë për sensibilitet dhe reagim institucional për krimet shtetërore të vrasjeve në kufi gjatë regjimit komunist. Link: <https://kohajone.com/politike/zhupa-nevoje-per-sensibilitet-dhe-reagim-institucional-per-krimet-shteterore-te-vrasjeve-ne-kufi-gjate-regjimit-komunist/>
- 17) Kuvendi i Republikës se Shqipërisë, si dhe burimet arkivore tw Autoritetit tw Dosjeve, ISKK, AP, KMD, etj.